

20251322901

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË MBROJTJES SË FËMIJËVE

Neni 1

Në Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut ” numër 104/19, 146/19, 275/19, 311/20, 294/21, 150/22, 236/22 dhe 17/22), në nenin 120, paragrafët (2) dhe (3) pas fjalëve: APTIS (APTIS)- të paktën niveli B2” shtohen fjalët: “ose certifikatë/vërtetim me të cilin vërtetohet njohja aktive e njërës prej tri gjuhëve më të përdorura të Bashkimit European, anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht.”

Neni 2

Neni 166-zh ndryshohet si vijon:

“(1) Drejtori i institucionit publik për fëmijë, si organ drejtues, ka të drejtë për rrogë dhe kompensime nga rroga, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë ligj dhe/ose marrëveshje kolektive.

(2) Rroga e drejtorit në institucionin për fëmijë llogaritet në shumë bruto dhe paguhet në shumë neto në para një herë në muaj në muajin aktual për muajin paraprak. Rroga përbëhet nga:

1) komponenti themelor dhe

2) komponenti i jashtëzakonshëm.

(3) Komponentin themelor të rrogës e përbëjnë:

1) rroga minimale,

2) pjesa e rrogës për shkallën e arsimit,

3) pjesa e rrogës për kapacitetet të projektuar dhe

4) pjesa e rrogës për stazh pune.

(4) Rroga minimale është ajo të cilën ministri i Ekonomisë dhe i Punës e boton në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligj.

(5) Pjesa e rrogës për shkallën e arsimit vlerësohet me 56 pikë.

(6) Pjesa e rrogës së drejtorit sipas kapacitetit të parashikuar të institucionit publik për fëmijë (kopsht/qendër për zhvillimin e fëmijërisë së hershme/pushimore për fëmijë) vlerësohet në pikë si më poshtë:

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar deri në 100 fëmijë.... 300 pikë,

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 101 deri në 200 fëmijë.... 315 pikë,

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 201 deri në 300 fëmijë.... 330 pikë,

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 301 deri në 400 fëmijë....345 pikë,

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 401 deri në 500 fëmijë....360 pikë,

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 501 deri në 600 fëmijë....375 pikë,

- për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 601 deri në 700 fëmijë....390 pikë,
 - për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 701 deri në 800 fëmijë.... 405 pikë,
 - për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 801 deri në 900 fëmijë....420 pikë,
 - për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar nga 901 deri në 1000 fëmijë....435 pikë,
 - për institucionin për fëmijë me kapacitet të parashikuar mbi 1000 fëmijë.... 450 pikë.
- (7) Pjesa e rrogës për stazhin e punës të drejtorit të institucionit publik për fëmijë, vlerësohet prej 0,5% të pjesëve të rrogës për shkallën e arsimit dhe sipas kapacitetit të parashikuar për çdo vit të kryer të stazhit të punës, dhe më së shumti deri në 20%.

Neni 3

Në nenin 176, pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

“(2) Anëtarëve të Komisionit nga paragrafi (1) i këtij neni, u takon kompensim me para, në shumë prej një të tretës së rrogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për çfarë ministri miraton aktvendim.”.

Neni 4

Në nenin 177-g, paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

“Personit përgjegjës nga paragrafi (8) dhe personave administrativë nga paragrafi (9) të këtij neni, u takon kompensim me para, në shumë prej një të tretës së rrogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për çfarë ministri miraton aktvendim.”.

Neni 5

Në nenin 177-gj, paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“Informatikan nga paragrafi (3) i këtij neni në rast kur provimi zbatohet në formë elektronike, i takon kompensim me para, në shumë prej një të tretës së rrogës mesatare neto në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për çfarë ministri miraton aktvendim.”

Neni 6

Në nenin 177-x, në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, dhe nëse kandidati flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të tij i mundësohet dhënia e provimit edhe në gjuhën që e flet dhe alfabetin e saj.”.

Pas paragrafit (5), shtohet paragraf i ri (6) si vijon:

“(6) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, në rast kur sistemi i vetëm elektronik për dhënien e provimit profesional për marrjen e licencës për punë nuk është në funksion, ndërsa për shkak të urgjencës së skajshme që mos ketë ngecje në kryerjen e vazhdueshme të procesit të licencimit, pjesa e dytë e provimit jepet në formë të shkruar, në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, ndërsa nëse kandidati e flet gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të tij i mundësohet ta japë provimin edhe në gjuhën që e flet dhe alfabetin e saj.”

Paragrafët (6) dhe (7), bëhen paragrafë (7) dhe (8).

Pas paragrafit (8), cili bëhet paragrafi (9), shtohet paragraf i ri (10), si vijon:

“(10) Mënyrën e dhënies së provimit nga paragrafët (3) dhe (6) të këtij neni, e përcakton ministri.”.

Neni 7

Në nenin 177-i, në paragrafin (2) numri “(6)” zëvendësohet me numrin “(7)”.

Neni 8

Dispozita e nenit 2 të këtij ligji me të cilën ndryshohet nenin 166-zh, do të zbatohen nga 1 korriku 2025.

Neni 9

Dispozitat e nenit 6 të këtij ligji, me të cilat plotësohet neni 177-x me paragrafin e ri (6), do të zbatohen deri më 1 janar 2026.

Neni 10

Akti nënligjor i paraparë me këtë ligj do të miratohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 11

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të konsoliduar të Ligjit të Mbrojtjes së Fëmijëve.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.